

# PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

## PËR AKTIVITETIN

### “Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme”

(te mbetjeve te lengeta/ngurta te ndotura me hidrokarbure te naftes bruto).

**Vendodhja:** Fshati Bradashesh, Njesia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan.

**Kërkues:** Subjekti: “Q.SINAJ” Sh.p.k

Hartoi:

“ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS” Sh.p.k  
(Çert. Nr. 551 Prot, dt. 24.10.2008)

Administrator  
Elidiana Shehu

Mars, 2024

## Tabela përmbledhëse

<b>1</b>	<b>TË PERGJITHSHME</b> .....	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>PËRSHKRIM I AKTIVITETIT</b> .....	<b>5</b>
	2.1 <i>Qëllimi i aktivitetit</i> .....	5
	2.2 <i>Pershkrimi i proceseve</i> .....	6
	2.3 <i>Vendodhja e objektit</i> .....	7
	2.4 <i>Infrastruktura</i> .....	8
<b>3.</b>	<b>VESHTRIMI MBI MJEDISIN</b> .....	<b>9</b>
	3.1. <i>Bashkia Elbasan</i> .....	9
	3.2. <i>Njesia Administrative Bradashesh</i> .....	9
	3.3. <i>Gjeografia, Klima</i> .....	10
	3.4. <i>Hidrografia, hidrogeologjia</i> .....	10
	3.5. <i>Pasurite floristike dhe fauna e zones</i> .....	10
	3.6. <i>Ekonomia</i> .....	11
	3.7. <i>Mjedisi biologjik i rajonit</i> .....	11
	3.8. <i>Ekosistemet ne rajon</i> .....	11
	3.9 <i>Sizmiciteti ne rajon</i> .....	12
	3.10 <i>Cilësia e ajrit</i> .....	12
<b>4.</b>	<b>VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS DHE MASAT PARANDALUESE</b> .....	<b>13</b>
	4.1. <i>Identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit</i> .....	13
	4.2. <i>Shkarkimet e mundshme ne mjedis</i> .....	14
	4.3. <i>Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis</i> .....	14

## 1 TË PERGJITHSHME

Subjekti "Q.SINAJ" sh.p.ki pajisur me numër NIPT-i: K82529403A, dhe seli ne fshatin Zharez. Rruga Fier, bashkia Fier, me administrator z. Baki Sinaj, aktualisht ushtron aktivitetin "Stacion Transferimi te mbetjeve te rrezikshme, riparim dhe mirembajtje te makinerive dhe pajisjeve, me vendodhje ne rajoni naftegazembajtese Patos-Marinez, Qarku Fier.

Te njejtin aktivitet "Stacion Transferimi per mbetje te rrezikshme", subjekti do te ushtroje edhe ne fshatin Bradashesh, Njesia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan.

Te dhenat e prones sipas certifikates se rregjistrimit te pasurise

- Pasuria nr. 912, volumi 5, faqe 136, zona kadastrale 3965 ne pronesi te Znj. Drita Ndue Sinaj dhe Z. Fatos Baki Sinaj

Shoqëria "Q.SINAJ" sh.p.k është një subjekt i cili prej vitesh zhvillonë aktivitetin e tij ekonomik si: Kryerja e punimeve per mirembajtjen, rikonstrukcion te ujesjelles kanalizimeve, pastrimit te mbeturinave. Transport i ujit industrial, Shërbim vakum për pastrim deposh, Shërbim i ujërave të zeza, tërheqje dhe transport i ujerave të zeza për në impiantet e riciklimit.

Aktiviteti ka për qëllim ndertimin e nje stacioni me qellim transferimin e mbetjeve te rrezikshme (te mbetjeve te lengeta/ngurta te ndotura me hidrokarbure te naftes bruto).

**Theksojme se subjekti "Q.SINAJ" sh.p.k disponon leje mjedisi per kete lloj aktiviteti ne nje tjeter vendodhje.**

Referuar instalimit te aktivitetit ne nje tjeter vendodhje, subjekti po ndjek procedurat sipas kerkesave ligjore ne fuqi per pajisje me leje mjedisore te tipit B, referuar ligjit 10448, date 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit", Shtojca 1, Menaxhimi I Mbetjeve Pika 5.10/a, Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart, te gjitha instalimet Leje B.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona eshte e distancuar nga zonat urbane dhe ndodhet 100 % ne zone industriale dhe ekonomike te qytetit te Elbasanit.



## 2 PËRSHKRIM I AKTIVITETIT

### 2.1 Qëllimi i aktivitetit

Aktiviteti ka për qëllim ndertimin e nje stacion transferimi per mbetje te rrezikshme.

Shoqeria disponon autobotet per transferimin e mbetjeve te rrezikshme. Mjetet e transportimit te mbetjeve te rrezikshme peshohen para fillimit te punes dhe ripesohen perseri pasi mbaron procesi i ngarkimit.

Autobotet sherbejne vetem per transferimin e mbetjeve te rrezikshme nga gjeneruesi drejt instalimeve per trajtimin dhe asgjesimin perfundimtar te mbetjeve.

Mjetet me vakum kryejne sherbimet si transport, pastrim, thithje. shtyrje te fluidit. larje oxhaku. etj.

Procedura per ngarkimin. transportimin dhe shkarkimin e mbetjeve te rrezikshme.

- Ngarkimi i automjeteve kryhet nermjet tubacioneve dhe valvula, duke u depozituar ne cisterne.
- Shkarkimi i materialit nga terheqja me gravitet nepermjet valvules se shkarkimit te vendosur ne pjesen e pasme te cisternes.
- Ngrija dhe hapja e pjeses se pasme te cisternes per te shkarkuar plotesisht mbetjet qe transferohen.

*Pajisjet qe shoqeria perdor per ushtrimin e aktivitetit*



Gjithashtu subjekti do te ushroj aktivitetin e Grumbullimit, transportit, ruajtjes, riciklimit, perpunimit te mbetjeve te lengeta/ngurta te ndotura me hidrokarbure te naftes bruto.

Ku nga sa me siper mund te permendim:

### *Transport i ujit industrial*

Nëpërmjet autobotëve që shoqëria “Q.Sinaj” shpk disponon, kryhet transporti i ujit i cili ndahet nga dekantimi i naftës bruto. Autobotet janë të pajisur me pompa dhe aksesoret përkatës për kryerjen e këtij shërbimi.



### *Transport i naftës dhe ujit sour*

Transport i naftës bruto dhe ujit i cili del nga ndarja e saj me përmbajtje të lartë të gazit H<sub>2</sub>S. Autobotët për kryerjen e këtij shërbimi janë inoks, 100% të izoluar, të pajisur me valvula sipas të gjitha standarteve për kryerjen e këtij shërbimi.



### *Shërbim vakum për pastrim deposh*

Shoqëria “Q. Sinaj” shpk ofron shërbim vakumi për pastrimin e fundit të depove , tubacioneve dhe gropave të puseve të naftës.



## **2.2. Pershkrimi i proceseve**

Per vendosjen ne funksionim te stacionit te transferimit te mbetjeve te rrezikshme ndiqen hapat e meposhtme:

- Grumbullimi i mbetjeve nga vendi ku gjenerohen dhe transportimi i tyre me mjetet teknologjike te shoqërise “Q.SINAJ” shpk, pasi shoqëria disponon Licence III.2.B, per transportimin e ketyre mbetjeve
- Mbetjet qe transportohen nga gjeneruesi per ne depozitat ne stacionin e transferimit(Bradashesh) do te shkarkohen nen kujdesin e drejtuesit teknik.
- Shkarkimi do te kryhet nga mjetet autobot direkt ne depozitat ku do te ruhen.
- Pasi te krijohet kapaciteti i mbetjeve qe mund te ruhet, mbetjet do te transportohen drejt subjektit qe do te kryej trajtimin e metejshem te tyre .



*Pamje te ambjenteve te mbrendshme te kaponit ku do te ushtrohet aktiviteti.*

Ne stacionin e transferimit te mbetjeve te rrezikshme realizohen dhe proceset per riparimin dhe mirembajtjen e makinerive dhe pajisjeve qe perdoren ne stacionin e transferimit, si aktivitet ndihmes I aktivitetit kryesor.

### **2.3 Vendodhja e objektit**

Aktiviteti i subjektit, do te ushtrohet ne zonen industriale te Elbasanit, Zona Kadastrale 3965, Nr. Pasurisë 912, ne fshatin Bradashesh, Njesia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan.

Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti ndodhet rreth 5 km. larg nga qendra e Qytetit të Elbasanit, në brendësi të zonës industriale të ish Kombinatit Metalurgjik. Largësia e objektit nga Lumi i Shkumbinit është 495 m.



Figure 2 – Harta e ndarjes administrative te bashkise Ibasan. (Burimi: ASIG Geoportal)

Zona ku do ushtrohet aktiviteti sipas studimit urbanistik bene pjese ne njesine strukturore 3/131 dhe eshte percaktuar per zhvillimie sipas kategorise IE Industri dhe Ekonomi 100%.

Zona e perzgjedhur per ushtrimin e ketij aktiviteti eshte e pershtatshme per kete lloj aktiviteti duke para parysysh per paresit si:

- Furnizimi me uje;
- Furnizimi me energji elektrike;
- Lehtesi ne aksesim nga automjetet (cisternat, automjetet qe furnizohen, zjarrfikset dhe ambulancat);

Sistemin Gauss-Kruger		
Nr	X	Y
1	4417993	4550540

#### 2.4. Infrastruktura

Infrastruktura e zonës në përgjithësi është e mire. Brenda këtij territori kemi infrastrukture ekzistuese duke qene se kjo zone eshte pjese Ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan, aktualisht ne pronesi te subjektit "KURUM INTERNATIONAL"SHA. Kjo zone e ka te ngritur infrastrukturen rrugore, linjat e energjise elektrike, linjat e furnizimit me uje si edhe rrjetin e kanalizimeve.



### **3. VESHTRIMI MBI MJEDISIN**

#### **3.1. Bashkia Elbasan**

Qyteti i Elbasanit shtrihet ne Fushen e Elbasanit ne krahun e djathte te rrjedhes se mesme te Shkumbinit, ne nje lartesi 120m mbi nivelin e detit. Qyteti eshte i rrethuar ne lindje nga Krasta a Madhe dhe e Vogel, nga kodrat e ullishtave ne veri-lindje dhe veri-perendim, i kufizuar nga lumi Shkumbin dhe kodrat e Hajdaranit ne jug. Ne menyre krejt natyrore kodrat formojne nje kurore te gjelber te plote dhe mjaft panoramike per qytetin.

Ne anën perëndimore të qytetit kalon përroi i Zaranikës dhe nga lindja ai i Manazderes. Aksesit ne qytetet sigurohet nepermjet 4 drejtimeve: Hyrja jugore nga kryqezimi i Cerrikut, 2 hyrjet perendimore dhe jug-perendimore (Ura e Zaranikes – rruga e vjeter dhe hyrja nga Autostrada), hyrja lindore (Ura e Bakallit). Qyteti pershkohet ne pjesen jugore te tij, pjeserisht pergjate segmentit te unazes me drejtim lindje – perendim, nga linja hekurudhore Pogradec-Tirane, si dhe nga gjurma e propozuar e Koridorit te Tete (pergjate lumit Shkumbin).

Qyteti i Elbasanit mbart vlera dhe pasuri historike, arkeologjike e etnografike te nje rendesie kombetare qe burojne nga ekzistenca e tij shumeshekullore si vendbanim. Vlera me e madhe historike dhe kulturore e qytetit eshte e perqendruar ne Kalane e Elbasanit dhe muret rrethuese te saj, qe perbejne qendrën historike dhe simbolin kryesor të qytetit të Elbasanit.

Sic u pershkrua ne seksionin e dyte, kjo zone paraqet nje “qytet me vete” - Qytetin Kala, me nje sipërfaqe 1.3 ha dhe ku ndodhen banesa me arkitekturë karakteristike që përfshihen në tipin e vecantë të banesës qytetare si edhe monumente te tjera. Kalaja e Elbasanit, ndër kalate me të mëdha fushore ne Ballkan, eshte jo vetem deshmi e tre periudhave historike te ndërtimit te saj, perkatesisht, romake ne shekujt 1-3, bizantine pas shekullit 6-7 dhe turke ne shekullin 15; kjo zone eshte gjithashtu nje ansambel monumental ku shkrihen vlerat me te rendesishme kulturore, arsimore, fetare, etj.

#### **3.2. Njesia Administrative Bradashesh**

Komuna Bradashesh ndodhet ne pjesen qendrore te Shqiperise, ne perendim te qytetit te Elbasanit, ne fushen me te njejtin emer. Relievi eshte tipik fushor e kodrinor i thyer, por me maja te buta. Kodrat ndodhen ne krahun e majte te perroit te Kushes me: Kodrat e Kusarthit, Balzes (ku shtrihet fabrika e Cimentos), Gurabardhit, Karakullakut (veshur me dushk), Kozanes, maja e Fungut, maja e Cirrumullit. Ne te djathte te perroit te Kushes deri tek perroi i Kalicoves ngrihet grupi i kodrave te Bradasheshit-Fikas (te veshur me ullinj e fiq) e te Shijonit. Grupi i fundit i kodrave eshte ai qe fillon nga Balldreni – Jatesh – Shemhill.

Hidrografia perbehet nga perroi i Kushes me deget e tij, perroi i Kalicoves etj. Ka burime nentokesore, ujembledhese. Ne kete komune ka dhe monumnete te natyres si:

Kalaja ne vendin e quajtur Shkemb i Skenderbeut (Sh. Lliut) ne fshatin Petresh e shpallur si monument kulture ne vitin 1973.

Eshte kala e bukur 14 Km larg Elbasanit dhe duhet te ecesh gjysem ore ne kembe. Komuna Bradashesh perfshin 17 fshatra: Bradashesh, Balez Lart, Balez Poshte, Kusarth, Kozan, Karakullak, Letan, Rrile,

Shtemaj, Ulen, Katund i ri, Fikas, Patresh, Shenmehill, Shijon, Reçan, Gurabardhe. Popullsia sot është 12642 banorë. Shtrihet në një sipërfaqe prej 55,2 km<sup>2</sup>. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qenë prodhimin drithrave të bukës dhe rritja e lopeve dhe të dhenvë. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 1600ha dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullota është 2092 ha. Sot aty veprojnë 93 biznese. Ka 9 kopshte fëmijësh, 8 shkolla fillore, 7 shkolla 9-vjeçare.

Popullsia e zonës është vendase, po ka të ardhur nga zona të tjera, sidomos nga Malesia e Martaneshit. Është e banuar që në kohërat e vjetra, ka monumente kulturore si: Stacioni At Quintum që është trakt i rrugës Egnatia, Manastiri i Gjon Vladimirit (i kohës bizantine), Cezmja e Kasines, etj.

### **3.3. Gjeografia, Klima**

Nga pikpamja gjeografike objekti lokalizohet në një terren kodrinor, duke qenë se bën pjesë në zonën kodrinore të vendit të tone, është terren malor, i ndërthurur me bimesë dhe pakëz (shkoze). Dimri, përgjithësisht, është i ashpër dhe me lagështi, kurse vera është e nxehtë dhe e thatë. Kjo zonë ka mbi 2500 ore ndriçim dielli në vit. Muaji me ndriçim më të gjatë është Korriku me 350 ore, kurse me ndriçimin më të shkurtër është Dhjetori, me 108 ore. Temperatura mesatare vjetore e ajrit është afërsisht 13.8 gradë Celsius. Muaji me temperaturën mesatare më të lartë është Gushti me 37 gradë Celsius, kurse ai me temperaturën më të ulët është Janari me -5 gradë Celsius. Në përgjithësi, ndryshimet më të mëdha të temperaturës janë graduale. Këto ndryshime janë më të mëdha kur kemi të bëjmë me ndryshimin e regjimit të stinëve. Ky fenomen ndodh në periudhat Mars – Prill dhe Tetor – Nëntor, kur kemi përkatësisht kalimin nga regjimi dimeror në atë pranveror dhe nga regjimi vjeshtor në atë dimeror. Vlera maksimale e temperaturës së ajrit në këtë zonë, me koeficient sigurie 50%, është rreth 37 gradë Celsius. Sipërfaqja e objektit nuk është e mbuluar me pyll, nuk është tokë bujqësore, mbi të nuk ka vepra arti, argjinatura dhe vepra hidroenergjetike.

### **3.4. Hidrografia, hidrogeologjia**

Duke gjykuar nga topografia e terrenit, ndërtimi gjeologjik i rajonit, topografia e zonës së objektit dhe të dhenat hidrogeologjike të marra nga punime të tjera të kryera në terren për qëllime të ndryshme gjatë kryerjes së punimeve gjeologjike, mund të themi se kushtet hidrogeologjike janë të thjeshta. Në afërsi të objektit ekziston një rezervuar.

Kushtet hidrogeologjike janë të thjeshta. Dallohen kryesisht ujra të çarjeve, debiti i të cilave varet nga reshjet atmosferike dhe nuk përben ndonjë problem të rëndësishëm për shfrytëzimin e objektit. Nga pikpamja hidrografike, objekti kufizohet me perrenj apo proska të vogla malore që kanë ujë vetëm në kohë reshjesh. Mineralizimi i ujerave është Hidro-karbonat magnezial i përdorshëm për t'u përdorur, me vlera maksimale të pH 5.8-7.2.

### **3.5. Pasuritë floristike dhe fauna e zonës**

Në zonën e shfrytëzimit nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me sataus të veçante. Flora dhe fauna lokale nuk do të preket nga shfrytëzimi, pasi sipërfaqja e objektit është pothuajse e zhveshur nga bimesia.

## Vleresime

Nga analiza e botes se gjalle mund te dalim ne keto konkluzione: zona ka bimesi te paket ku midis tyre dallohen ekosistemet e shkurreve , si edhe ajo e siperfaqeve te degraduara. Te gjitha keto ekosisteme nuk kane vlera te vecanta sidomos ne sektore te caktuar me vlera shkencore dhe turistike. Siperfaqja e objektit nuk eshte e mbuluar me pyll, nuk eshte toke bujqesore, mbi te nuk ka vepra arti , argjinatura dhe vepra hidroenergjetike.

### Popullsia dhe aspekte sociale te saj

Popullsia per rreth zonës eshte perqendruar ne zonen industriale te ish kombinatit te metarlurgjikut ku permbliidhen disa fshatra si : Bradasheshi , Vidhasi , zona e banuar Ish kombinati te cilat ndodhen ne afesi te objektit. Popullsia e zone i kalon 10.000 banore . Ne afersi te zones dhe rrotull saj nuk ndodhet asnje objekt qe te perbeje rrezik gjate punimeve te shfrytezimit. Ne zonen ku parashikohet te behet shfrytezimi nuk ka toke bujqesore, nuk ka vepra arti , argjinatura dhe vepra hidroenergjetike.

### **3.6. Ekonomia**

Ne zonen e Bradasheshit te qarkut te Elbasanit historikisht dhe tradicionalisht, e cila vazhdon edhe sot, ka qene pjese industria. Burimi kryesor ekonomik i kesaj zone ne ditet e sotme ngelet emigrimi.

### **3.7. Mjedisi biologjik i rajonit**

- Zonat e Mbrojtura

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN.

Pervec statusit te mesiperem te zonave te mbrojtura mund te jene edhe objekte te vecanta me status “Monument Natyror”, te cilat per rajonin ne vleresim nuk preken nga ky projekt.

### **3.8. Ekosistemet ne rajon**

#### Flora

Aspekti faunistik i lidhur ngushtë me mjedisin rrethues, paraqet një larmi biologjike tepër të varfër, që është po kështu një pasqyrim i gjendjes së këtij ekosistemi tashmë tepër të degraduar. Vlerat e tanishme faunistike të zonës janë elementare. Takohen shumë pak përfaqësues të shpendëve dhe reptilëve të takuar përgjatë kohës së eksplorimit të zonës.

Fauna, e këtushme shënon lloje tipike të një rajoni që ofrom mundësi të kufizuara për ushqim dhe vendstrehim.

Bazuar në vëzhgimet e terrenit nuk është e vështirë që të nxiret si perfundim se fauna e këtushme është tepër e varfër.

## Fauna

Mund të themi se zona është brenda konturit të një zone industriale, një zone që nuk dallohet për faunë të pasur apo të mbrojtur nga legjislacioni në fuqi dhe nuk është ndonjë zonë shumë e frekuentuar nga shpende shtegëtar pasi nuk është burim i pasur ushqimi për ta. Normalisht nëse zona do të kishte një bimësi shkurrëse që është tipike për një vend mesdhetar si ky, atëherë larmia e shpendëve do të ishte tërheqëse.

### 3.9 Sizmiciteti në rajon

Trualli Shqiptar vendoset gjatë kufirit të përplasjes së dy pllakave të mëdha që levizin njëra kundër tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe është vater e përqendruar tërmetesh e cila preket me shpesh nga tërmete demtues.

Si shumë zona të tjera të vendit edhe kjo zonë është zonë e prekur nga tërmetet, ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund të goditet nga tërmete me magnitudë  $M_{max}=5.5-6.0$  grade Richter me intensitet deri në 7 balle MKS-64 e cila shkakton çarje në mur dhe rrezim të copave të suvash por për objektet e uleta nuk parashikohen shqetësime. Si dhe mundësitë për të goditur tërmetet me shumë balle janë të vogla rreth 20%.

### 3.10 Cilësia e ajrit

Shkarkimet e gazeve acide në atmosferë kanë një ndikim negativ mbi ekosistemet e ujërave të ëmbla, të cilat janë të ndjeshme ndaj aciditetit si edhe ndaj cilësisë dhe përbërjes kimike të tokës. Gjithashtu, kjo dukuri shkakton dëmtime në trashëgiminë kulturore sepse pakëson gradualisht cilësinë dhe fortësinë e monumenteve kulturore, ndërtesave prej mermeri etj. Për më tepër, çlirimi i përbërësve të azotit në atmosferë, shkakton atrofizimin në ekosistemet tokësore dhe detare.

Burimi kryesor i çlirimeve të substancave acide në mjedis janë emetimet e gazta, që përmbajnë dyoksid sulfurit  $SO_2$ , okside të azotit  $NO_x$  dhe amoniak  $NH_3$ . Këto gaze krijohen gjatë djegies së substancave organike të djegshme në sektorët e shërbimeve, transportit, prodhimit të energjisë, industrisë kimike dhe metalurgjike etj. Pas çlirimit në atmosferë, këto gaze shpërndahen në hapësirë dhe mund të qëndrojnë për disa kohë në gjendje të shpërhapur.

Gazet  $SO_2$ ,  $NO_x$ , dhe  $NH_3$  bien direkt në sipërfaqen e tokës dhe vendosen në bimësi dhe elementë të tjerë mjedisorë ose bien në gjendje të lagësht së bashku me borën, shiun, mjegullën etj. Këto gaze (si rezultat i zhvillimit të disa reaksioneve kimike) shndërrohen në acide squfuri dhe azoti kur ato qëndrojnë në atmosferë, si edhe kur bien në tokë. Ligji Nr. 8934, i datës 5 Shtator 2002 mbi Mbrojtjen e Mjedisit siguron për adoptimin e programeve të kontrollit të ndotjes në Shqipëri, megjithatë për zonën në vlerësim nuk ka të dhëna të publikuara mbi cilësinë ekzistuese të ajrit të lidhura me çlirimin e  $SO_2$  ose  $NH_3$ .

## Zhurmat

Lidhur me zhurmat, në zonën e studimit nuk ka ndonjë informacion në lidhje me nivelet e ndotjes së ambientit. Zhurma nuk është shqetësimi kryesor në zonën që rrethon këto zone rurale drejtpërdrejt.

Nivelet e zhurmës brenda fshatrave janë tipike për çdo zonë rurale te nivelit të fshatrave dhe janë të lidhura kryesisht me trafikun e automjeteve që është në nivel minimal por infrastruktura ndikon në rritjen e këtij niveli. Megjithatë rekomandohet që nivelet e zhurmës duhet të monitorohen gjatë operimit.

#### **4. VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS DHE MASAT PARANDALUESE**

##### **4.1. Identifikimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit**

###### **4.1.1. Shkarkime në ujë**

Zhvillimi i aktivitetit nuk e përdor ujë në procese teknologjike, pra nuk do të ketë shkarkim të ujerave të ndotura. Ujërat e shiut do të sistemohen përmes kanaleve perimetrike dhe do të bashkohen në kanalizime të zonës. Të vetmet ujëra që gjenerohen janë ujërat sanitare nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve.

###### **4.1.2. Emetime në ajër**

Mbetjet që do të magazinohen do të jenë brenda depozitave metalike të mbyllura dhe të etiketuara (në përputhje me ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve), si dhe do të vendosen në sheshin ku zhvillohet aktiviteti. Në këtë mënyrë nuk parashikohet të ketë ndikime pasi mbetja do të jetë e mbyllur dhe brenda kontenerit, deri në momentin kur do të dorëzohet të asgjësuesi final.

Në rast se do të ketë emergjencë (rrjedhje nga depozita) do të zbatohet plani i emergjencës të cilin kompania do të hartojë, si dhe do të nderhyet vetëm me persona të trajnuar dhe autorizuar.

Aktiviteti që synon të zhvillohet nuk ka në procesin e punës burime të cilat mund ndikojnë në krijimin e gazeve apo pluhurave. Gjatë momentit të transportit të mbetjeve nga kompania transportuese mund të ketë ndikime të lehta për persona të përket pluhurit dhe emetimit të gazeve nga makineritë e transportit.

###### **4.1.3. Ndikimi në tokë**

Mbetjet do të ruhen në depozita metalike. Ndotje të tokës mund të ketë vetëm në rastet aksidentale të rrjedhjeve të depozitave.

###### **4.1.4. Ndikimi në biodiversitet**

Sipas verifikimeve të kryera lloji i aktivitetit nuk ndikon në biodiversitet. Flora dhe fauna e zonës nuk do të ndikohet nga aktiviteti i shoqërisë.

###### **4.1.5. Zhurmat dhe vibrimet**

Aktiviteti i punës është i tillë që nuk ka burime fikse të zhurmës, duke qenë se procesi i punës përfshin vetëm magazinim. Gjithsesi si impakt zhurma mund të vijë nga mjetet e transportit të mbetjeve. Subjekti duhet të kujdeset që transporti të kryhet në orare të caktuara (jo heret në mëngjes apo vonë në mbremje), si dhe makineritë e kompanisë transportuese të jenë në gjendje të mirë pune dhe i një viti të ri prodhimi.

#### 4.1.6. Ndikime socio-ekonomike

Nuk parashikohen të shkaktohen ndikime negative nga zhvillimi i projekteve të tilla në pjesën sociale ekonomike, për arsye se këto projekte ndihmojnë në rritjen e punesimit.

#### 4.2. Shkarkimet e mundshme ne mjedis

Uji do perdoret per lagjen e territorit per pakesimin e pluhurave gjate procesit te levizjes se automjeteve dhe do sigurohet permes depozitave nga shoqeria.

Ujera te ndotura nuk do te kete, sepse uji nuk perdoret ne procese teknologjike.

Ujerat e shiut do te sistemohen permes kanaleve perimetrike dhe me pas do i bashkohen kanalizimeve kulluese te zones. Theksojme se keto ujerat nuk permbajn elemente kimike ndotes.

Zhurmat kryesisht do te krijohen nga levizja e automjeteve. Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Çdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit. Energjia zvoglohet per gjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve, divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Program i perdorur per llogaritjen e nivelit te zhurmave merr parasysh faktori "A" – niveli i presionit te zhurmes te llogaritur

Faktori « A » perbehet nga kontribuesit qe vijojne Niveli i fuqise se zhurmes ne drejtim te perhapjes  $L_{ne\ drejtim\ te\ eres} = L_{W} - A$

Niveli i zhurmave te ketyre automjeteve , eshte i atij niveli qe nuk influencon si per te punesuarit dhe per banoret dhe gjallesat per rreth tij. Fenomene te tilla si vibracion zhvillimi i aktivitetit nuk do te kete.

Mbetjet qe krijohen do te jene vetem mbetje me karakter urbane nga aktiviteti i perditshem i punonjesve. Keto mbetje do te grumbullohn ne kosha plastike dhe me pas do te depozitohen ne vendin e caktuar nga bashkia.

#### 4.3. Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis

Me qellim qe te parandalohen , shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marr masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit. Këto masa përfshijnë masa të përgjithshme, si dhe për minimizimin e impakteve negative.

Nr	Lloji i ndikimit	Masa për zbutjen e ndikimit
1	Emetimet ne ajer, pluhura dhe gaze	- Kontrolli periodik i makinerive për të siguruar emetim brenda normave të lejuara; - Planifikimi paraprak i punës dhe realizimi në kohë sa më të shkurtër. - Spërkatja me ujë (veçanërisht në kohë të thatë) të territorit ku

		zhvillohet aktiviteti
2	Krijimi i zhurmave	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të mirëmbahen automjetet e punës;</li> <li>- Të ndalohet rënia e borive në zonat e banuara;</li> <li>- Në zonat e banuara të qarkullohet me shpejtësi të kufizuar;</li> <li>- Makinat e transportit dhe pajisjet të jenë bashkëkohore që plotësojnë standardet kombëtare, të pajisura me marmitë selenciatore të pakësimit të zhurmave</li> </ul>
3	Gjenerimi i mbetjeve	<p>Mbetjet urbane vlerësohen të jenë në sasi të vogël, për menaxhimin e tyre kompania të zbatojë masat:</p> <p>Mbetjet do të meren nga një person përgjegjës për tu dërguar në kontenierët e përcaktuar nga pushteti vendor.</p>